



SH.A. UJËSJELLËS - KANALIZIME KRUJË

Water Supply and Sewerage Enterprise Kruja

Nr ____ Prot

Datë ____/____/2021

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT ¹

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

15.11.2021

Drejtuar: **“HH CONSULTING & SERVICES STUDIO” shpk** Adresa: Tirane Tirane TIRANE
Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Kulla 3, Shkalla 3, Kati 2, Nr.4

Procedura e prokurimit/lotit **“Rivlersim Asetesh te shoqerise Ujësjellës Kanalizime Kruje Sh.a** ,,

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-05071-09-13-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rivlersim Asetesh te shoqerise Ujësjellës Kanalizime Kruje Sh.a** ,, me afat **45 dite nga nenshkrimi i kontrates.**] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike [140] [20 shator 2021]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. 6D – PLAN shpk

L62717405H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 3.500.000 (tre milion e peseqind mije) leke pa tvsh

¹ Ky Formular eshte i aplikueshem nese ka Ankime

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. HH CONSULTING & SERVICES STUDIO shpk
Emri i plotë i shoqërisë

L41705012R
Numri i NIPT-it

Vlera 3.600.000 (tre milion e gjashtëqind mijë) leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. UNITEC-STUDIO shpk
Emri i plotë i shoqërisë

K72316010C
Numri i NIPT-it

Vlera 4.000.000 (kater milion) leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. UNITEC-STUDIO shpk

K72316010C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Kjo OE skualifikohet për arsyejet e mëposhtme:

- a. Oferta është shumë e lartë se fondit limit I parashikuar për këtë procedurë .
- b. Kjo OE nuk plotëson kriteret në **Aftësitë teknike dhe profesionale: perkatesisht** kriterin **2.3.4 pika a** ku nuk disponon numrin e kërkuar të ekspertëve vlerësuesve të pasurive të paluajtshme me license të shkallës së parë , ky operator ekonomik disponon vetëm 1 ekspert vlerësues të pasurive të paluajtshme me license të shkallës së parë nga 3 të kërkuar në kriterin 2.3.4/a . **Ne kriterin 2.3.4. pika b) gjithashtu duhet të kenë edhe staf të profileve** O.E Unitec ka ngarkuar në sistem vetëm licencën e një eksperti fiskal, ku kjo e fundit nuk rezultoi të jetë në listpagesat e muajve të kërkuar në kriteret kualifikuese të A. Të kontraktuar, nuk disponon një kontratë pune ndërmjet unitec dhe ekspertit, nuk është ngarkuar në sistem cv dhe as diploma e ekspertit.
- c. Në kriterin 2.3.5 O.E nuk disponon numrin e ekspertëve vlerësues me certifikatat përkatëse të kërkuara në kriterin, por të gjitha këto certifikata I disponon vetëm një ekspert I vetëm cka nuk sjell në mos plotësimin e kriterit të kualifikimit 2.3.5 nga A.K sepse numri I kërkuar në kriterin me sipër bazohet në ecurinë dhe kohën e mbarimit të vlerësimit të aseteve që disponon UKK. *Ritheksojmë se ky proces bëhet për herë të parë nga AK -UKK dhe është shumë i rëndësishëm, sidomos në afatet dhe cilësinë e tij, pasi rivlerësimi i aseteve të UKK do të jetë i një rëndësie të vecantë për UKK dhe si i tillë është interes i AK*

që ky proces të kryhet nga OE të cilët garantojnë cilësinë për të cilën ky proces mos të jetë i kontestueshem përgjatë procesit të mëvonshëm për institucionin e UKK.

- d. **Ky OE Nuk ploteson kriterin 2.3.6 “Stafi duhet të kete ne perberje te tij eksperte mes te cileve qe ne kompleksitet garantojne eksperience ne.....” Dokumentacioni i ngarkuar ne sistem nuk eshte sipas kerkesave te kerkuar ne kriterin kualifikues te kerkuar nga A.K.**
- e. **Ky OE Nuk ploteson kriterin 2.3.7 sepse nuk disponon nje certifikate vleresime nga subjektet e cituara ne kriter.**

2. 6D – PLAN shpk

L62717405H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Kjo OE skualifikohet per arsyejet e meposhtme:

- a. **OE nuk ka siguruar oferten sipas shtojces nr 3 ne baze te ligjit Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” neni 83 Sigurimi i ofertës**

*1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Ky kriter eshte kerkuar edhe ne DST e ngarkuara ne sistem nga AK perkatesisht ne : **Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** **3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3. Shuma e sigurimit të ofertës është 74.000 (shtateqind e dyzet mije) leke***

- b. **Ne kriterin 2.3.2 “Operatori ekonomik duhet të jete i licensuar ne institucionin licencues ne te tre fushat e kerkuara (shkalla e pare) nga jo me pak se 2 vjet, me te drejte te ushtroje aktivitetin e vleresimit pa asnje kufizim ne fushat e meposhtme sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 712, datë 12.10.2016....” Saktësisht Pika c) Për Linja teknologjike, makineri e pajisje. (Shkalle e pare) O.E e disponon nje certifikate te shkalles se pare si person juridik por kjo certifikate ka nje afat me pak si dy vite cka nuk e ploteson afatin e vendosur ne kriterin e kualifikimit 2.3.2 nga jo me pak se dy vjet.**
- c. **Ne kriterin 2.3.5 O.E nuk disponon numrin 3 te eksperteve vleresues me certifikatat perkatese te kerkuara ne kriterin 2.3.5 , me sakte ka 4 eksperte qe disponojne certifikaten e shkalles se pare te kerkuar ne piken a te kriterit “Për Ndërtesa dhe tokë truall, (License te shkalles se pare)” dhe 1(nje) ekspert vleresues qe disponon kategorit e certifikatave te kerkuara ne piken b dhe c te kriterit. Sa me sakte ne kriterin 2.3.5 nuk jane kerkuar**

thjesht eksperte qe disponojne certifikata te ketyre kategorive per keto certifikata te disponohen nga 3 eksperte te ndryshem sepse ky kriter eshte vendosur duke u bazuar ne natyren qe ka ky objekt prokurimi dhe afatin qe duhet te perfundoje kjo procedure . Ritheksojmë se ky proces bëhet për herë të parë nga AK -UKK dhe është shumë i rëndësishëm, sidomos në afatet dhe cilësinë e tij, pasi rivlerësimi i aseteve të UKK do të jetë i një rëndësie të vecantë për UKK dhe si i tillë është interes i AK që ky proces të kryhet nga OE të cilët garantojnë cilësinë për të cilën ky proces mos të jetë i kontestueshem përgjatë procesit të mëvonshëm për institucionin e UKK.

- d. Ne Kriteri 2.3.6 OE nuk ka ngarkuar ne sistem asnje dokumentacion mbi keter kriter.
- e. **Ky OE Nuk ploteson kriterin 2.3.7** OE nuk ka ngarkuar ne sistem asnje certifikate vleresimi nga sub shteterore apo private .
- f. **Ky OE Nuk ploteson kriterin 2.3.8** OE nuk ka ngarkuar ne sistem vertetimin qe nuk ka mare asnje sanksion ne tre vitet e fundit per shkelje nga Komisioni I Posacem I Licensave.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë HH CONSULTING & SERVICES STUDIO shpk Adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Kulla 3, Shkalla 3, Kati 2, Nr.4, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera 3.600.000 (tre milion e gjashteqind mije) pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë /HH CONSULTING & SERVICES STUDIO shpk / **sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Me date 06.10.2021 eshte paraqitur Formulari i Ankeses nga Operatori Ekonomik i “6d-Plan” shpk

(Vendimit te KPP Nr. 824/2021 date 29.10.2021)

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI

Edi Salaj